



Klinasi mbante nën kërcënim të armës ish-gruan dhe dy vajzat e saj, ndërhyjnë policia

KRONIKA | October 11, 2022 - 11:02

SHPËRNDAJE: [f](#) [t](#)

Policia e Kosovës ka arrestuar një person në fshatin Sferkë të Klinës, nën dyshimin për dhunë në familje dhe armëmbajtje pa leje.

Policia ka njoftuar se ai është arrestuar, pasi ka mbajtur pa dëshirën e tyre ish-bashkëshorten dhe dy vajzat e saj në shtëpinë e tij.

"Më datë 10 tetor 2022 rreth orës 18:00, Stacioni Policor Klinë, ka pranuar informacion nga Drejtoria e Zbatimit Ndërkombëtar të Ligjit, (ILECU) DPP Prishtinë, se një shtetase Austriake së bashku me dy vajzat e saj, është duke u mbajtur pa dëshirën e saj nga ish- bashkëshorti në shtëpinë e tij në fshatin Sferkë-Klinë, i cili poashtu dyshohet se posedon armë zjarri. Policia menjëherë ka dalë në vendngjarje, ka arrestuar personin e dyshuar, ndërsa viktimë së bashku me vajzat e saj janë shoqëruar në Stacionin Policor në Klinë.Viktima është intervistuar në prezencën avokatit mbrojtës dhe përkthyesit ligjor, pas intervistimit e njëjta është dërguar në shtëpinë e sigurt", thuhet në njoftim.


Po ashtu bëhet e ditur se i dyshuari, pas intervistimit, me urdhër të prokurorit të Shtetit, është dërguar në mbajtje për 48 orë.

"Gjatë bisedës me prindin e të dyshuarit, i njëjti pranon se posedon një armë 'AK 47', një karikator të së njëjtës armë dhe dyzet e tre (43) copë fishekë të kalibrit 7.62 x 39 mm. Arma është sekuestruar nga hetuesit. I dyshuari për rastin e armës pas intervistimit, me vendim të prokurorit të Shtetit, është liruar në procedurë të rregullt", thuhet në njoftim. /Zëri




Arma e sekuestruar

Të rekomanduara



Prishtinasi thotë se u rrëmbye nga dy persona...

October 11, 2022



Klinasi mbante nën kërcënim të armës...

October 11, 2022

Vrau për gjakmarrje bashkëshatarin, 17-vjeçari nga Lezha dënohet me 8 vjet burg

KRONIKA | October 11, 2022

Konflikt mes dy familjeve në Prizren për pyllin që s'ishte i asnjërës

KRONIKA | October 10, 2022

Rrokulliset me traktor, vdes një person në Prizren

KRONIKA | October 10, 2022

Bie nga traktori, vdes 2-vjeçari në Podujevë

KRONIKA | October 10, 2022

Arratiset nga qelia shqiptari i dënuar me burgim të përjetshëm në Greqi

KRONIKA | October 09, 2022

Operacion ndërkombëtar kundër drogës, arrestohet një turk – dy shqiptarë në kërkim

KRONIKA | October 09, 2022

Më të lexuarat



Sulmohet në Serbi nga persona të maskuar autobusi i linjës Zvicër – Kosovë



Bie nga traktori, vdes 2-vjeçari në Podujevë




Vdes 21-vjeçari me prejardhje nga Presheva që u aksidentua në Bern



Shoferja e mitur godet me veturë një femër në Prishtinë



Rreth 100 mijë euro me fajde, rrëfimi i dëshmitarit në Gjykatë ndaj tre të akuzuarve



Gruaja në Malishevë dyshohet se rrahu fëmijën e saj trevjeçar dhe burrin